Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-716 Datë: 30.07.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.07.2026 merr:

V E N D I M

1. Riakreditohet dhe rivalidohet **Instituti për Aftësim Profesional dhe Përkrahje të Punësimit "DITURIA"**, me seli në: Rezistenca e Verrinit, Prizren, Kosovë, për një periudhë prej pesë (5) vite, nga 18.07.2026 deri më 19.07.2031, për ofrimin e kualifikimit:
   1.1. **"Furrëtar", Niveli III, sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), me 10 (dhjetë) kredi, kualifikim i bazuar në Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D). Numri i kandidatëve për një grup është 6 (gjashtë).** Gjatë një cikli trajnimi 7-javor, mund të trajnohen 2 (dy) grupe (në dy turne), me gjithsej 12 (dymbëdhjetë) kandidatë. Për një vit kalendarik, qendra mund të trajnojë gjithsej 7 (shtatë) grupe, me një numër total prej 84 (tetëdhjetë e katër) kandidatësh.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së: **Institutit për Aftësim Profesional dhe Përkrahje të Punësimit "DITURIA"**, të parashtruar në AKK, për akreditim dhe validim të **Institutit për Aftësim Profesional dhe Përkrahje të Punësimit** për kualifikimin: **"Furrëtar"**, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim për kualifikimin si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit më: 15.06.2026 për kualifikimin: **"Furrëtar"**, Niveli III ndërsa vizita është realizuar me datën 18.06.2026. Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 19.07.2026. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit

dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 30.07.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese. AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASH Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. "Instituti për Aftësim Profesional dhe Përkrahje të Punësimit "DITURIA""
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar KD së AKK